



Financuar nga
Bashkimi Evropian



DOKUMENT ORIENTUES PËR PËRFSHIRJEN E RINISË NË PLANET LOKALE

BASHKIA GJIROKASTËR



Dokument orientues për përfshirjen e rinisë në planet lokale Bashkia Gjirokastër

Ky dokument u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve me mbështetjen e UNFPA Shqipëri në kuadër të Projektit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri: “Zbatimi i Kuadrit Ligjor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që po zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian, përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Ky dokument përmban mendimet dhe pikëpamjet e shprehura nga autorët dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo organizmave të saj.

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	4
Falenderime	5
I. Hyrje	6
II. Kompetencat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Rininë dhe BarazinëGjinore (kuadri ligjor dhe institucional)	7
III. Profili i Bashkisë Gjirokastrë mbi rininë dhe dhunën me bazëgjinore	11
3.1 Informacion në lidhje me dokumentet politike (Strategji, Plane) që adresojnë të rinjtë dhe të rejtat dhe dhunën me bazë gjinore.....	11
3.2 Shërbimet/ strukturat rinore të ngritura nga Bashkia për pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve dhe të rejave në vendimmarrjen lokale.....	12
3.3 Buxheti për rininë dhe ai gjinor nga Bashkia.....	13
IV. Prioritetet e të rinjve dhe të rejave - Bashkia Gjirokastrë	15
V. Hartëzimi i detyrimeve ligjore për Bashkinë dhe aktivitetet e realizuara me fokus rininë dhe barazinë gjinore	16
VI. Rekomandime me fokus të rinjtë/ të rejtat dhe çështjet gjinore – Bashkia Gjirokastrë	26
VII. Referenca	29
VIII. Shtojca	30
8.1 Lista e programeve aktive për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe të rejave në Shqipëri.....	30

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi European
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KKR	Këshilli Kombëtar i Rinisë
KVR	Këshilli Vendor i Rinisë
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
QKF	Qendra Kulturore e Fëmijëve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qendrushëm
NjA	Njësia Administrative
NjMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NjQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNFPA	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Falenderime

Ky raport është realizuar nga [Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve](#) (Observatori) në kuadër të programit “**Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri**”, i zbatuar në kuadër të Fondit të Përsheptimit të OKB-së për Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZhQ) në Shqipëri nga UN Women me UNFPA, financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian (BE-së).

Ky program ka për qëllim arritjen e rezultateve pozitive të zhvillimit socio-ekonomik për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë në Shqipëri. Në zbatim të këtij programi, Observatori u angazhua në mbështetjen e Bashkive Elbasan, Gramsh, Gjirokastrë, Korçë dhe Tiranë për përfshirjen e praktikave të ndjeshme gjinore për të rinjtë në planet sociale të zhvillimit të qytetit.

Një falenderim i shkon stafit të Bashkisë së Gjirokastrës, që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundësuar të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe shërbimet për të rinjtë dhe barazinë gjinore. Në veçanti, falenderojmë z. Flamur Golemi – Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë, z. Florian Berberi - Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), znj. Artiste Koko - Drejtorja e Financës, z. Blerim Kore - Drejtorja e Turizmit, znj. Albana Allushaj - Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësor, znj. Melpomeni Manxhari – Barazia Gjinore dhe koordinatore e Këshillit Vendor Rinor.

Falenderojmë partnerët Act for Society dhe Albanian Community Assist, për bashkërendimin e punës në vlerësimin e nevojave dhe vjeljen e opinioneve të të rinjve dhe të rejave të bashkisë Gjirokastrë.

Falenderojmë znj. Loreta Mamani për lehtësimin e komunikimit dhe mbledhjen e të dhënave në Bashkinë Gjirokastrë.

Dokumenti u hartua nën:

- *Supervizimin e* Elma Tërshana, Drejtore Ekzekutive e Observatorit
- *Menaxhimin e* Eridjona Vallja, Menaxhere programi e Observatorit
- *Kontributin e* Elsona Agolli, Analiste e Programit Gjinor UNFPA

I. Hyrje

Hartimi i këtij dokumenti vjen si nevojë e kompetencave dhe përgjegjësi të shtuara të organeve të pushtetit vendor, referuar si në reformën territoriale (2015), si dhe në reflektim të detyrimeve ligjore diktuar nga ligjet e reja, sic është ai për rininë. Strategjitë kombëtare të ndërtura përgjatë këtyre dy viteve (2021, 2022) për rininë dhe barazinë gjinore, diktojnë një vëmendje të shtuar të organeve të pushtetit lokal në këto çështje.

Bashkia, si niveli i tretë i pushtetit vendor dhe njësi bazë e qeverisjes vendore, është institucioni ku të gjitha nevojat e grupeve dhe individëve adresohen për zgjidhje apo lehtësime të mëtejshme. Duke konsideruar Bashkinë si njësinë bazë e cila jo vetëm administron territore dhe objekte por dhe lehtëson nevojat e grupeve/ individëve në nevojë dhe përmirëson jetën dhe mirëqënien e banorëve të saj, - është e rëndësishme adresimi i drejtë për drejtë i nevojave nëpërmjet planeve dhe strategjive lokale.

E vlerësojmë të rëndësishëm këtë dokument informues për bashkinë Gjirokastrë, i cili vjen si një udhëzues i gërshtuar me gjithë detyrimet ligjore aktuale dhe nevojat për adresim të të rinjve dhe të rejave dhe trajtim të çështjeve gjinore, për qeverisjen vendore. Ky material orientues prezantohet nga Observatori, një organizatë me eksperiencë 10 vjeçare në fushën e hartëzimit të nevojave dhe prioriteteve të pushtetit lokal referuar grupeve në nevojë. Për hartimin e këtij udhëzuesi janë shqyrtuar ligjet për funksionimin e pushtetit vendor¹, për rininë² dhe barazinë gjinore³, apo strategji kombëtare⁴. Gjithashtu një vëmendje të shtuar ka patur dhe komunikimi i drejtë për drejtë me punonjësit dhe punonjëset e bashkisë Gjirokastrë nga sektorë të ndryshëm.

Materiali në vijim prezanton një panoramë të detyrimeve ligjore të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për hartimin e politikave lokale me fokus të veçantë të rinjtë dhe të rejtat dhe çështjet gjinore duke marrë në konsideratë prioritetet e artikuluara nga vetë të rinjtë.

Ky dokument është hartuar për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë në hartimin e politikave lokale të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe rinisë.

Ky udhëzues mund t'u vijë në ndihmë dhe ekspertëve, politik-bërës, media dhe jo vetëm, - duke i informuar si rreth detyrimeve ligjore ashtu dhe mbi politikat aktuale të pushtetit vendor, në interes të nevojave për adresim për rininë dhe çështjeve gjinore për bashkinë Gjirokastrë.

¹ Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

² Ligji 75/2019 "Për rininë".

³ Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".

⁴ Strategjia Kombëtare ndërsektoriale e Rinisë 2022-2029; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

II. Kompetencat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Rininë dhe Barazinë Gjinore (kuadri ligjor dhe institucional)

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NjQV) kanë detyra dhe kompetenca specifike për rininë dhe çështjet gjinore, të diktuar nga ligje të ndryshme dhe plane strategjike kombëtare. Më poshtë paraqiten **kompetencat për rininë dhe çështjet gjinore nga NjQV**, të diktuar nga:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 75/2019 “Për rininë”
- Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Strategjia Kombëtare ndërsektoriale e Rinisë 2022-2029
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030

1. **Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë dhe çështjeve gjinore.

Konkretisht këto detyrime evidentohen në:

- (i) *Nenin 1*, ku përcaktohet se NjQV krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore;
- (ii) *Nenin 3*, ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, në pikat d), dh) dhe f) sipas të cilave realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- (iii) *Nenin 23*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj);
- (iv) *Nenin 24*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale;
- (v) *Nenin 25*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- (vi) *Nenin 26*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- (vii) *Nenin 28*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- (viii) *Nenin 29*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike;
- (ix) *Nenin 59*, ku përcaktohet se Kryetari/ kryetarja e Bashkisë në emërimet e zëvendës kryetareve/ kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratorëve/ administratorëve të njësive administrative zbaton dhe respekton barazinë gjinore.

Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. **Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, i cili në:

- (i) *Nenin 38, pika 2* përcakton që pas finalizimit të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore të

marrë masa për publikimin e tij dhe më pas të organizojë seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit⁵. Në këtë kuadër, bashkitë mund dhe duhet të mbështetin iniciativat planifikuese buxhetore për të rejat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislationin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim.

3. **Ligji 75/2019 “Për rininë”**, si një ligj bazë për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe të rejave në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve dhe të rejave, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore për rininë në këtë ligj përcaktohen në:

- (i) *Nenin 5*, ku theksohet se njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të:
- Bashkëpunoj me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikën, projektet e programet në fushën e rinisë;
 - Kontribuoj në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë.
- (ii) *Nenin 7*, ku përcaktohen kompetencat specifike të njësive të vetëqeverisjes vendore, si më konkretisht:
- Njësitet e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikën vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:
 - pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve dhe të rejave, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
 - krijimin e Këshillit Vendor të Rinisë (KVR);
 - organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve dhe të rejave;
 - organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve dhe të rejave;
 - nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe të rejave dhe edukimin joformal të tyre;
 - financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
 - krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
 - parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve dhe të rejave për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
 - mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve dhe të rejave në territorin e tyre.
 - Njësitet e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

⁵ Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16

- Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.
 - Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimit në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.
- (iii) *Nenin 10*, ku përcaktohet se:
- KVR është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. KVR ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - vlerëson situatën e të rinjve dhe të rejave dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve dhe të rejave në territorin ku veprojnë;
 - bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë (KKR).
 - KVR kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.
 - Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVR, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të KVR miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke i'u referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për KKR.

4. Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, si një ligj rregullator i çështjeve themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore për çështjet gjinore në këtë ligj përcaktohen në:

- (i) *Nenin 14*, ku theksohet se njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të:
- Bashkëpunoj me organet e qeverisjes qendrore për zbatimin e legjisllacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore⁶.
 - Bashkëpunoj ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, në territorin që mbulojnë⁷.
 - Kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë⁸.
 - Emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të barazisë gjinore, pranë tyre⁹.

⁶ Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 14, pika 1

⁷ Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 14, pika 2

⁸ Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 14, pika 3

5. **Strategjia Kombëtare ndërsektoriale e Rinisë 2022-2029**¹⁰, si një dokument që do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj.

Kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore për çështjet gjinore në këtë strategji përcaktohen në:

- (i) *Pikën 2.2.1*, ku theksohet krijimi i KVR si një organ këshillimor, i cili funksionon në varësi të kryetarit të bashkisë në çdo bashki.
- (ii) *Pikën 2.2.6*, në të cilën Bashkitë, sipas ligjit për rininë, kanë një punonjës të specializuar për çështjet Rinore, dhe në varësi të madhësisë së tyre, zakonisht kanë një Drejtor ose Njësi për Shërbimet Sociale, ku përfshihen përgjegjësitë për çështjet që lidhen me rininë.
- (iii) *Pikën 4.3.2*, në të cilën Bashkitë duhet të zhvillojnë dhe aplikojnë shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë që përfshijnë kënde informacioni rinor (info-points).
- (iv) *Pikën 5.2.1*, për lehtësimin e aksesit në kredi dhe mbështetjen e shtuar qeveritare për krijimin e fondeve për start-up duke i kushtuar shumë rëndësi edhe promovimit të këtyre skemave në çdo bashki si popullatën rinore të bashkisë por edhe për ata që kthehen nga migrimi.
- (v) *Pikën 5.3.2*, për të mbështetur dhe lehtësuar angazhimin dhe ndërveprimin mes KVR-ve dhe ndërmartjeve vendore e start-up-eve, për të përmirësuar mundësitë e punës për të rinjtë në bashkitë ku jetojnë.
- (vi) *Pikën 6.3.6*, për të forcuar masat për trajtimin e çështjeve të strehimit për të rinjtë, të tilla si subvencionimi i strehimit për të rinjtë në nevojë dhe ndërtimi i shtëpive për të rinjtë (programet e strehimit të bashkive kanë kuota specifike për të rinjtë).
- (vii) *Pikën 6.3.8*, për sigurimin e mjediseve të kohës së lirë dhe sportive në çdo bashki, bazuar në kërkesat e të rinjve dhe të rejave të shprehura në konsultime kombëtare.

6. **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030**, si një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktiket e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

⁹ Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 14, pika 4

¹⁰ Versioni draft i Strategjisë së Rinisë, Mars 2022.

Kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore për barazinë gjinore në këtë strategji përcaktohen në:

- (i) *Pikën 3.5*, ku theksohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë një person të dedikuar vetëm si Koordinatorë/ Koordinator Vendor kundër dhunës në familje në të gjitha bashkitë në vend.
- (ii) *Pikën 4.3*, ku theksohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë rregullisht analizën gjinore dhe monitorojnë buxhetin nga këndvështrimi gjinor.

III. Profili i Bashkisë Gjirokastër mbi rininë dhe dhunën me bazë gjinore

3.1 Informacion në lidhje me dokumentet politike (Strategji, Plane) që adresojnë të rinjtë dhe të rejtat dhe dhunën me bazë gjinore

Bashkia Gjirokastër ka disa dokumente politike (Strategji, Plane) të miratuara në nivel lokal, si:

- i. Plani për integrimin e pakicave romë dhe egjyptiane <https://www.vendime.al/vendimi-keshillit-bashkiak-gjirokaster-nr-41-date-26-03-2019/>;
- ii. Plani social (2019-2022);
- iii. Plani për personat me Aftësi të Kufizuara (2020-2022);
- iv. Plani i Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Bashkia Gjirokastër **nuk ka një Plan Veprimi për Rininë**. Gjithashtu kjo Bashki nuk ka një manual mbi standardet për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimit të të rinjve dhe të rejave.

Dhunës me bazë gjinore i është vënë një fokus i veçantë në dokumentet politike në nivel lokal të Bashkisë Gjirokastër, si:

- Në Planin Social të Bashkisë Gjirokastër (2019-2022), konkretisht në Objektivin specifik 1 ‘Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje’, ku përfitues janë:
 - o Punonjësit e institucioneve që kanë përgjegjësi ligjore për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, që koordinojnë e ndërveprojnë më mirë për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës.
 - o Gratë në tërësi dhe viktimat e dhunës në familje në veçanti në territorin e bashkisë Gjirokastër, përfitojnë nga ndërveprimi mes institucioneve për të zbatuar efektivisht parashikimet ligjore për barazinë gjinore dhe adresimin e dhunës në familje.
- Në Planin Lokal për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Gjirokastër (2020-2022), një ndër objektivat specifike është planifikimi dhe ngritja e shërbimeve alternative të kujdesit shoqëror, që përfshin dhe shërbimin e punësimit me mbështetje të të rinjve/ të rejave me aftësi të kufizuara.
- Në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gjirokastër 2020-2023, një ndër objektivat specifike është rishikimi i planeve/ programeve/ rregulloreve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe atij të Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore me qëllim përfshirjen në to të çështjeve të grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Bashkia Gjirokastrë aktualisht është duke punuar për hartimin dhe miratimin e **Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në përputhje me Kartën Evropiane për Barazinë të grave dhe burrave në jetën vendore**, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazinë të grave dhe burrave në jetën vendore.

3.2 Shërbimet/ strukturat rinore të ngritura nga Bashkia për pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve dhe të rejave në vendimmarrjen lokale

Gjirokastra është një nga bashkitë me numër të ulët të të rinjve dhe të rejave në nivel kombëtar¹¹, konkretisht me 10,685 të rinj dhe të reja ose 1.03% e të rinjve dhe të rejave¹².

Bashkia Gjirokastrë ka një **Strukturë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror**, që është Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, e cila ndër të tjera siguron dhe hartimin/ zbatimin e sistemit të treguesve për matjen e performancës, në të cilin përfshihen edhe tregues të aspektit gjinor. Kjo drejtori ka në varësinë e saj dhe sektorin e Njësisë së Mbrojtjes Sociale të Fëmijëve. Në Bashkinë Gjirokastrë ka një **Specialist Kundër Dhunës në Familje**. Në Bashkinë Gjirokastrë ka një punonjës të dedikuar për rininë. Në këtë Bashki ka njësi/ department/ drejtori të dedikuar për barazinë gjinore. Roli i KV është i ndarë nga ai i nënpunësit/es së barazisë gjinore. Këto funksione mbulojnë nga dy specialistë.

- **Ndër shërbimet që ofrohen për të rinjtë në Bashkinë Gjirokastrë, janë:**
 - Shërbime trajtimi për fëmijë, të rinj dhe të reja me aftësi të kufizuara nga të gjitha bashkitë e qarkut (Tepelenë, Memaliaj, Gjirokastrë dhe Libohovë).
 - Bashkia Gjirokastrë ka realizuar aktivitete rinore dhe me bazë gjinore në bashkëpunim me institucione të tjera, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), organizata të ndryshme jo-fitimprurëse etj. Me ngritjen e KRV-së të rinjtë dhe të rejat do të jenë aktiv në vendimmarrjen lokale.
 - Të rinjtë dhe të rejat janë në fokus të një sërë shërbimesh të ofruara nga Bashkia Gjirokastrë.

Bazuar në informacionin e dhënë nga bashkia, situata në lidhje me të rinjtë paraqitet si në vijim:

- Në Gjirokastrë ka gjithsej 8 (tetë) shkolla të mesme¹³, 1 universitet publik, 1 (një) Qendër Rinore dhe 1 (një) Qendra Kulture e Fëmijëve (QKF), ndërkohë nuk ka qendra multi-funksionale.
- Në këtë Bashki ka organizata lokale që veprojnë me një fokus të veçantë të rinjtë¹⁴.
- **Bashkia Gjirokastrë ka ngritur një Bord Rinor Këshillimor** si një instrument për sigurimin e angazhimit dhe kontributit rinor.
- Bashkia Gjirokastrë ka hartuar aplikime/ projekte me fokus rininë.
- Bashkia Gjirokastrë ka realizuar Bashkia aplikime/ projekte me fokus barazinë gjinore, sikundër është projekti për ngritjen e qendrës 72 orëshe kundër dhunës me bazë gjinore, si një bashkëfinancim i MShMS dhe Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2019-2022.

¹¹ Grupmoshë e përcaktuar sipas Ligjit 75/2019 “Për rininë”, miratuar në 4.11.2019, neni 3, pika f, fq 2.

¹² Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Grupmosha 15-29 vjeç, viti 2018

¹³ 6 shkolla të mesme publike të përgjithshme, 1 shkollë e mesme jo-publike, 1 shkollë e mesme profesionale.

¹⁴ 2 organizata lokale

- Njoftimet e ndryshme mbi çështjet sociale, shëndetësore, arsimore etj pasqyrohen online në faqen e internetit të bashkisë së Gjirokastrës www.bashkiagjirokaster.gov.al. Në këtë faqe janë pasqyruar disa prej aktiviteteve kryesore të të rinjve dhe të rejave të cilët kanë ndërmarrë në menyrë të vazhdueshme nisma të cilat janë suportuar nga bashkia, si:
 - *Nisma për një ambient/ mjedis të pastër*: Të rinjtë, në qytetin e Gjirokastrës, janë bërë pjesë e Planit Kombëtar të Pastrimit. Ambientalistët e rinj janë angazhuar në nisma të ndryshme për largimin e mbetjeve urbane, si në zonën përreth Urës së Ali Pashës, në lagjen “Dunavat”, të njohura si pika të vizituara edhe nga turistët vendas dhe të huaj.¹⁵
 - *Nisma për promovimin e traditës dhe kulturës së Gjirokastrës*: Për 16-vjetorin e përfshirjes së iso-polifonisë në UNESCO, në Gjirokastrë, u festua promovimi i traditës dhe kulturës popullore. Përgjatë aktiviteteve u promovuan vlerat e folklorit, etnografisë, traditës, veshjeve popullore të trashëguara në breza duke apeluar për domosdoshmërinë e mbajtjes gjallë dhe përcimit të tyre tek të rinjtë. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë u organizua në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. 250 artistë dhe artiste popullore, pjesëmarrës në festival nga hapësira mbarëshqiptare, shpalosën vlerat më të arrira të folkut ndërsa u vlerësua dhe kontributi në vite i mbartësve të spikatur të isopolifonisë. Vlerat e traditës popullore janë një aset i paçmuar kombëtar por edhe një pikë e fortë për zhvillimin e turizmit në Gjirokastrë¹⁶.
 - *Nismat sportive*: Bashkia Gjirokastrë ka investuar për rikonstruksionin e terreneve sportive, sikundër është instalimi i impiantit të ndriçimit në Fushën e Vjetër, duke i mundësuar të rinjve dhe të rejave ambjente dhe kushte bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve dhe eventeve sportive. Tashmë, ky mjedis frekuentohet gjithmonë e më shumë, nga fëmijët dhe të rinjtë. Bashkia Gjirokastrë e ka në fokus të punës së saj vazhdimin e investimeve për rehabilitimin e terreneve dhe këndeve sportive, në qytet dhe njësitë administrative¹⁷.
 - *Nismat për promovimin e vlerave të traditës në kulinari duke shkëmbyer eksperiencat me shtetet e tjera*: Aktivitete të tilla janë një mundësi e mirë për njohjen e traditave dhe kulturës vendase dhe të huaj kryesisht nga të rinjtë. Bashkia Gjirokastrë është e angazhuar në bashkëpunimin dypalësh për konkretizimin e disa projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore, arsimit, promovimin e vlerave të përbashkëta kulturore dhe zhvillimin e turizmit¹⁸.
- Bashkia ***nuk ka bërë ndonjë vlerësim/ anketim për të identifikuar nevojat dhe prioritetet*** e të rinjve dhe të rejave në Gjirokastrë.
- Këshilli Bashkiak ***nuk ka organizuar seanca dëgjimore të veçanta për problemet e rinisë***.

3.3 Buxhetimi për rininë dhe ai gjinor nga Bashkia

Sipas Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024 në Bashkinë e Gjirokastrës kategoria e të rinjve dhe të rejave nuk është e buxhetuar në mënyrë direkte nëpërmjet

¹⁵ Nëntor 2021.

¹⁶ Dhjetor 2021.

¹⁷ Maj 2021.

¹⁸ Nëntor 2021.


aktiviteteve dhe programeve apo shërbimeve të caktuara. Megjithatë departamentet/ programet në Bashki, buxheti i të cilave i dedikohet direkt ose indirekt rinisë janë:

- Investimet arsimore
- Investimet Publike
- Departamenti i Kulturës dhe Sportit, nëpërmjet aktiviteteve sociale për të rinjtë dhe të rejtat të buxhetuara
- Investimet në fushën sociale

IV. Prioritetet e të rinjve dhe të rejave - Bashkia Gjirokastër

Në kuadër të programit “**Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri**”, Qendra Act for Society dhe Albanian Community Assist, me mbështetjen e UN Women, Zyrës së UNFPA-së Shqipëri dhe i financuar nga BE nëpërmjet Fondit të Përsheptimit të SDG-ve të OKB-së në Shqipëri, realizuan një vlerësim të nevojave të komunitetit për edukim mbi aftësitë jetësore, dhunën me bazë gjinore, shërbimet e ofruara nga sektori publik dhe privat¹⁹. Më poshtë paraqiten disa prej gjetjeve kryesore nga vlerësimi i nevojave në Njësinë Administrative (NjA) Lunxheri, në Bashkinë Gjirokastër.

Numri i pjesëmarrësve në anketimin e realizuar në NjA Lunxhëri ishte **83** të rinj dhe të reja të grupmoshës 15 deri në 30 vjeç, nga të cilët **58** vajza (70%) dhe **25** djem (30%).



Grafik 1: Përqindja e pjesëmarrësve në anketim

Gjetjet kryesore nga anketa e të rinjve dhe të rejave të realizuar në fshatrat Erind, Valare, Karjan, Kakoz dhe Nokov kishin të bënin me arsimin, çështjet formale dhe joformale, ekonomike dhe sociale. Lidhur me dhunën brenda familjes, disa të reja raportuan se numri i grave që janë viktime të dhunës në familje tani raportojnë në polici apo institucione të tjera. Sipas tyre, dhuna psikologjike është më e shpeshtë. Gjatë diskutimit ata treguan interes për zhvillimin e trajnimeve të disiplinës pozitive që kanë të bëjnë me mënyrën e trajtimit dhe menaxhimit të situatave konfliktuale që lindin në marrëdhëniet familjare.

Ndër problemet kryesore që raportojnë të rinjtë dhe të rejat në komunitetin e Lunxhërisë janë:

1. Role të forta gjinore
2. Mungesa e objekteve sportive dhe të tjera sociale
3. Mungesa e trajnimeve për edukimin e aftësive jetësore, sipërmarrjen, fuqizimin social

Kërkesat kishin të bënin kryesisht me trajnimin e të rinjve dhe të rejave, si të bëhen sipërmarrës, shkëmbimin e përvojave me të rinj dhe të reja nga qytete të ndryshme, zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe argëtuese, trajnime në bazë gjinore, fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, shërbime për të moshuarit. etj.

¹⁹ Të dhënat e vlerësimit i janë referuar periudhës Dhjetor 2021.

V. Hartëzimi i detyrimeve ligjore për Bashkinë dhe aktivitetet e realizuara me fokus rinorë dhe barazim gjinorë

Në tabelën e mëposhtme paraqiten përcaktimet ligjore për NJQV në lidhje me zhvillimin e politikave vendore rinore/ gjinore, si dhe angazhimet e realizuara nga Bashkia në përmbushje të tyre.

	Nr	Përcaktimet ligjore për NJQV në lidhje me zhvillimin e politikave vendore rinore/ gjinore	Detyrimet/ aktivitetet/ tregues që rrjedhin për NJQV ²⁰	Angazhime të realizuara gjatë periudhës 2020-2021	Premtime në Plan buxhetin e Bashkisë viti 2022
Ligji për vetëqeverisjen vendore – Kryesisht angazhime në parim	1	Realizimi i shërbimeve nga Qeverisja Vendore duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antarëve/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore ²¹ .	- NJQV zhvillon një plan strategji zhvillimi; ²² - Planet e NJQV duhet të jenë në harmoni me ato kombëtare dhe rajonale. ²³		
	2	Funksionet e bashkisë në	- Realizimi i veprimtarive	Qendra Komunitare në Lagjen Zinxhira.	Rikonstruksioni i

²⁰ Këto detyrime/ aktivitete/ tregues janë gjeneruar bazuar në ligjet përkatëse.

²¹ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 3: pikat d), dh) dhe f).

²² Diktuar nga ligji përkatës;

²³ Diktuar nga ligji përkatës;

	fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj) ²⁴ .	me dhe për rininë në fusha të ndryshme (shëndet, arsim, sociale, mjedis, etj). ²⁵	Fusha sportive në shkollën “Bilal Golemi” Lazarat.	godinave dhe ambienteve të institucioneve arsimore në vlerën 4.104.000 lekë
3	Funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale	- NjQV ndërmerr shërbime sociale targetuar rininë. ²⁶	Mbështetja e familje me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare. Kurse profesionale për të rinjtë dhe të rejtat precedentë penal. Mbështetje psiko-sociale dhe ligjore për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ndërmjetësime për të rinjtë dhe të rejtat në konflikt me ligjin.	
4	Funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. ²⁷	- NjQV bashkëorganizon me të rinjtë dhe të rejtat veprimtari në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. ²⁸	QKF Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për aktivitete shlodhëse ose sportive. Mbështetje për ekipet sportive të të rinjve dhe të rejtave.	
5	Funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së	- NjQV bashkëorganizon me të rinjtë dhe të rejtat		

²⁴ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 23;

²⁵ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti

²⁶ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti

²⁷ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 25;

²⁸ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

	mjedisit. ²⁹	veprimtari në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si: informim, ndërgjegjësim, edukim, apo qoftë dhe ngrijten e guidave dhe aktiviteteteve publike, organizuar me të rinjtë dhe të rejat për promovimin e turizimit lokal, pastrimin mjedisi, etj.		
6	Funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor ³⁰ .	- NjQV ndërmerr nisma për fuqizimin ekonomik të të rinjve dhe të rejave, si: realizimi i kurseve të ndryshme të zhvillimit profesional, bashkëpunimi me donatorë apo organizata, etj. ³¹	Realizimi i kurseve të të rinjve dhe të rejave mbështetur nga organizata të ndryshme.	
7	Funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike ³² .	- NjQV ndërmerr nisma të gërshetuara dhe me institucionet e tjera lokale për çështje të sigurisë publike.	Në vitin 2021 është ngritur Komiteti i Sigurisë Publike Vendore.	

²⁹ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 26;

³⁰ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 28;

³¹ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

³² Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 29;

	8	Detyrimi për konsultime publike nga NjQV ³³ .	NjQV organizon minimalisht 1 seancë konsultimi publik në (1) vit, me grupet e ndryshme të interesit që jetojnë në territorin e Bashkisë. ³⁴	Po bëhen konsultime vendore me publikun e gjerë.	2 herë në vit
	9	Krijimi i komiteteve/ bordeve duke respektuar barazinë gjinore ³⁵	NjQV krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.		
	10	Detyrim i zbatimit dhe respektimit të barazisë gjinore ³⁶ .	Kryetari/ kryetarja e NjQV në emërimet e zëvendës kryetareve/ kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratoreve/ administratorëve të njësive administrative zbaton dhe respekton barazinë gjinore.	Po zbatohet ligji përkatës nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.	

³³ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 16;

³⁴ Diktuar nga ligji përkatës;

³⁵ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 1;

³⁶ Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 59;

Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore	1	Kryetari i NjQV organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për projekt dokumentin e PBA të rishikuar ³⁷ .	NjQV mund dhe duhet të mbështetin iniciativat të buxhetuara për rininë në linjë me nevojat e tyre. ³⁸	Po, çdo fund viti	
Ligji për Rininë (2019)	1	NjQV bashkëpunon me MASR për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë. ³⁹	NjQV harton plane strategjike për programe në fushën e rinisë. ⁴⁰		
	2	NjQV kontribuoj në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë dhe të rejtat në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimin e të rinjve dhe të rejave. ⁴¹	NjQV harton standartet për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimin e të rinjve dhe të rejave. ⁴²		
	3	NjQV në përputhje me	Përcakton objektiva dhe		

³⁷ Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 38, pika 2;

³⁸ Diktuar nga ligji përkatës;

³⁹ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 5;

⁴⁰ Diktuar nga ligji përkatës;

⁴¹ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 5;

⁴² Diktuar nga ligji përkatës;

	funksonet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë. ⁴³	prioritete për të siguruar zbatimin e të drejtave të të rinjve dhe të rejave ⁴⁴		
3.1		KVR si organ këshillimor, funksionon pranë kryetarit të bashkisë. KVR kryesohet nga Kryetari dhe ka minimalisht 4-6 të rinj dhe të reja anëtarë. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVR, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak ⁴⁵ .		
3.2		Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive për fuqizimin dhe mbrojtjen e të rinjve dhe të rejave ⁴⁶		
3.3		Organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve dhe të		

⁴³ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 7;

⁴⁴ Diktuar nga ligji përkatës;

⁴⁵ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 10;

⁴⁶ Diktuar nga ligji përkatës;

		rejave ⁴⁷		
3.4		Nxhitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe të rejave dhe edukimin joformal të tyre. ⁴⁸		
3.5		Financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta, - si Qendra rinore. ⁴⁹		
3.6		Krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë, si pjesë e NjQV. ⁵⁰		
3.7		NjQV mbledh, analizon dhe raporton për situatën e të drejtave të të rinjve dhe të rejave. ⁵¹		
4	NjQV aplikon për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe	Numri i aplikimeve të realizuara dhe të fituara nga NjQV me fokus ose		

⁴⁷ Diktuar nga ligji përkatës;

⁴⁸ Diktuar nga ligji përkatës;

⁴⁹ Diktuar nga ligji përkatës;

⁵⁰ Diktuar nga ligji përkatës;

⁵¹ Diktuar nga ligji përkatës;

		ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi. ⁵²	përfshirë tematikën rinore. ⁵³		
	5	NjQV bashkëpunon me institucione të tjera vendore nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore. ⁵⁴	- Numri i marrëveshjeve të realizuara me fockus ose përfshirë tematikën rinore. ⁵⁵ - Bashkëpunime të NjQV me institucione të tjera vendore. ⁵⁶		
	6	NjQV bashkëpunon me organizatat për të rinjtë dhe të rejtat e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë dhe të rejtat shqiptarë të Bashkisë, që janë larguar nga Bashkia apo vendi. ⁵⁷	Numri i bashkëpunimeve apo aktiviteteve të tilla të realizuara. ⁵⁸		

⁵² Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 7;

⁵³ Diktuar nga ligji përkatës;

⁵⁴ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 7;

⁵⁵ Diktuar nga ligji përkatës;

⁵⁶ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁵⁷ Ligji 75/2019 “Për rininë”, Neni 7;

⁵⁸ Diktuar nga ligji përkatës;

OZHQ	1	OZHQ – Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe të rejave në aktivitete për arritjen e OZHQ	- NjQV bashkërendon politikat dhe nismat me/dhe për rininë në gërshetim me OZHQ. ⁵⁹		
Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”	1	Adresimi i barazisë gjinore ⁶⁰	Adresimi i çështjeve të barazisë gjinore dhe emërimi i një ose më shumë punonjëseve/punonjësve vendorë të barazisë gjinore.	Ka strukturë të ngritur.	2021, 2022

⁵⁹ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁶⁰Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 14, pika 4;

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030	1	<p>Buxhetet e NjQV reflektojnë zbatimin korrekt të legjislacionit mbi aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor⁶¹</p> <p>Përmirësimi i funksionimit të mekanizimit të koordinimit të referimit në nivel vendor⁶²</p>	<p>NjQV kryejnë rregullisht analizën gjinore dhe monitorimin e buxhetit nga këndvështrimi gjinor</p> <p>NjQV përcaktojnë një person të dedikuar vetëm si Koordinatore / Koordinator Vendor kundër dhunës në familje në të gjitha bashkitë në vend.</p>	Barazia gjinore është e buxhetuar	
---	---	--	--	-----------------------------------	--

⁶¹ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Pika 4.3

⁶² Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Pika 3.5

VI. Rekomandime me fokus të rinjtë/ të rejat dhe çështjet gjinore – Bashkia Gjirokastrë

Bashkia Gjirokastrë, si një bashki me shumë objekte dhe vlera historike, bukuri natyrore dhe me një kuzhinë të pasur dhe tradicionale vlerësohet si një nga zonat turistike më të vizituara në vend. Të rinjtë dhe të rejat e bashkisë Gjirokastrë, mund të luajnë një rol kryesor si mbajtës dhe ruajtës të traditës dhe kulturës gjirokastrite. Bashkia Gjirokastrë mund të luajë një rol të rëndësishëm në angazhimin, përfshirjen dhe nxitjen e të rinjve dhe të rejave për të qenë aktorë dhe kontribues në zhvillimin e aktiviteteve dhe nismave të ndryshme kulturore dhe turistike.

Bashkia Gjirokastrë këto 3 vitet e fundit, ka zhvilluar aktivitete me dhe për të rinjtë dhe të rejat në lidhje me një mjedis të pastër, investime në terrene sportive, kulinari dhe festime të ndryshme. Aktivitete të tilla duhet të jenë më intensive dhe më të gjera në kohëzgjatje dhe në grupe të caktuara rinore.

Bashkia Gjirokastrë, në përmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësisë të saj për përmirësimin e situatës së të rinjve dhe të rejave të Gjirokastrës, në zbatim të Ligjit 75/2019 “Për rininë”, si dhe akteve të tjera ligjore që i japin kompetenca specifike në këtë fushë, mund të ndërmarrë nisma dhe politika për rininë dhe barazinë gjinore, si më poshtë:

1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rinjve dhe të rejave në proceset dhe vendimmarrjet demokratike

- Ngritja dhe funksionimi i KVR-së.
- Përfshirja e dimensionit gjinor dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë në përfaqësimin dhe jetën politike, në sesione për edukimin qytetar, në shkollat publike (të mesme).
- Takime sensibilizuese me të rinjtë dhe të rejat e zonave rurale dhe urbane, si dhe me të rinjtë dhe të rejat me aftësi të kufizuara, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në procesin e votimit (individual e të lirë), në zgjedhjet vendore dhe qendrore.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rolet gjinore dhe llojet e dhunës.
- Hartimi dhe zbatimi i një plani për integrimin dhe fuqizimin e të rinjve dhe të rejave, referuar dhe profilit të tyre, si
 - Të rinj dhe të reja në arsimin e mesëm,
 - Të rinj dhe të reja pjesë e programeve të aftësisë dhe trajnimeve profesionale
 - Të rinj dhe të reja punë kërkues të papunë
 - Të rinj dhe të reja as në punë, arsim apo aftësim
 - Të rinj dhe të reja me aftësi të kufizuara
 - Të rinj dhe të reja të angazhuar në martesë para moshës 18 vjeç dhe që rezultojnë në situatë të vështirë ekonomike dhe sociale
 - Të rinj dhe të reja kryefamiljar dhe në situatë të vështirë ekonomike dhe sociale

2. Nxitja e punësimit të të rinjve dhe të rejave përmes politikave efektive të tregut të punës⁶³

- Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Gjirokastrës, në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen në këtë Bashki.
- Organizimi i takimeve sensibilizuese me të rinjtë dhe të rejtat mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional të bazuara në nevojat dhe specifikat e zonës.
- Mbështetja e aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rinjve dhe të rejave.
- Seminare informuese dhe trajnuese me nxënës/et e shkollave të mesme mbi rëndësinë e të sfiduarit të stereotipeve gjinore në punësim.
- Panairi i ideve në kuadër të “Ditës Botërore të Aftësive të të rinjve dhe të rejave”, bazuar në trajnimet e formimit profesional të ofruara mbi bazën e nevojave dhe karakteristikave të zonës.
- Aktivitete për rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe të rejave për sipërmarrjen dhe edukimin e aftësive të buta.
- Ngritja dhe funksionimi i një platforme komunikimi dhe informimi për të përmirësuar mundësitë për punësimin e të rinjve dhe të rejave, e cila mund të shërbejë dhe si platformë komunikimi mes ofruesve formalë dhe jo-formalë të të mësuarit, bizneseve dhe agjencive të punësimin.
- Bashkërendimi i punës me strukturat dhe institucionet përkatëse lokale, të mbështesë dhe lehtësojë angazhimin dhe ndërveprimin mes KVR dhe ndërmarrjeve vendore e start-up-eve, për të përmirësuar mundësitë e punës për të rinjtë dhe të rejtat në bashkitë ku jetojnë.

3. Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe të rejave në aktivitete mjedisore dhe turistike

- Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe të rejave në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe turistike në nivel lokal.
- Aktivitete pastrimi, pyllëzimi, riciklimi, promovimi i turizmit me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rinjve dhe të rejave, si dhe komunitetit në tërësi mbi mbrojtjen e mjedisit.
- Aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e gjeneratës së re.
- Aktivitete me të rinjtë dhe të rejtat që janë larguar nga bashkia për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin e tyre në aktivitetet që promovojnë kulturën, turizmin dhe vlerat e bashkisë.

4. Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe të rejave në aktivitete artistike e kulturore

- Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër, animacione) të krijuara nga të rinjtë dhe të rejtat e shkollave të Gjirokastrës dhe përfshirja e tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme të qytetit.
- Promovimi i jetës artistike dhe kulturore përmes organizimit të aktiviteteve artistike-kulturore në zonat urbane dhe në zonat rurale.
- Programe sensibilizuese në mediat lokale mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të të rinjve, të rejave, vajzave dhe djemve në veprimtari sportive, artistike dhe kulturore, përfshirë edhe ato që tradicionalisht shihen si aktivitete kryesisht “për vajza” ose “për djem”.

⁶³ Në Shtojcën A gjendet Lista e programeve aktive për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe të rejave në Shqipëri

- 5. Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe të rejave në aktivitete edukuese shëndetësore**
- Aktivitete që promovojnë një kulturë të hapur dhe të lirë rreth shëndetit të të rinjve dhe të rejave, për të ulur stigmatizmin dhe diskriminimin.
 - Konkurse mes shkollave të mesme mbi rolin e qeverisjes vendore në çështje të shëndetit të të rinjve dhe të rejave.
 - Krijimi i ambienteve sportive në mënyrë që të rinjtë dhe të rejat të kalojnë kohë së bashku pas shkollës.
 - Të krijohen objekte arti dhe sociale, që mund të shfrytëzohen nga të rinjtë dhe të rejat përgjatë kohës së lirë.
- 6. Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe të rejave në aktivitete për arritjen e OZHQ**
- Aktivitete informuese mbi OZHQ me qëllim njohjen e tyre dhe sensibilizimin e të rinjve dhe të rejave mbi rolin që mund dhe duhet të luajnë për përmbushjen e këtyre objektivave.
 - Hartimi i planit të veprimeve për përfshirjen e të rinjve dhe të rejave në arritjen e OZHQ.
 - Zbatimi i planit të hartuar, duke ofruar mbështetjen e duhur financiare, infrastrukturore, etj.
- 7. Zhvillimi i politikave të integruara për punësimin e të rinjve dhe të rejave**
- Bashkërendimi i punës së Bashkisë Gjirokastrë me institucionet e tjera lokale (zyra e shërbimit social shtetëror rajonal, zyra rajonale e punësimit, shkollat profesionale në bashkinë/ rajonin përkatës), me qëllim ndërtimin e planeve individuale për punësimin e të rinjve dhe të rejave, të cilët janë punëkërkues të papunë. Ky rekomandim bazohet dhe në “Urdhërin e përbashkët nr.52, datë (26.01.2022), për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune”; si dhe në modelin që tashmë po ndërtohet në gjithë vendin bazuar në Vendim Nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndër-institucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”.
 - Për një qasje të drejtëpërdrejtë të nevojave të të rinjve dhe të rejave sipas profileve të lartpërmendura, Bashkia rekomandohet që të ngrëjë dhe pasurojë një databazë me të dhënat e këtyre të rinjve dhe të rejave (emër, mbiemër, mjet identifikimi, formimi, dëshirat dhe interesat për zhvillim/ arsimim/ punësim).

VII. Referenca

Dokumente:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 75/2019 “Për rininë”
- Ligji nr. 9770, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Strategjia Kombëtare ndërsektorale e Rinisë 2022-2029
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030
- Plani social i Bashkisë Gjirokastrë (2019-2022);
- Plani për personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gjirokastrë (2020-2022);
- Plani i Zhvillimit Ekonomik Lokal në Bashkinë Gjirokastrë
- VKM 23.02.2018 “Fondi i Social i Punësimit”
- VKM nr.535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”
- VKM 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme

Linqe:

- <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-gjirokaster-nr-41-date-26-03-2019/>;
- <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1161&langId=en>
- [MAPS Report web.pdf \(un.org.al\)](#)
- [Bashkia Gjirokastrë – Gjirokastra Municipality](#)

VIII. Shtojca

8.1 *Lista e programeve aktive për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe të rejave në Shqipëri*

- **Fondi i Social i Punësimit**⁶⁴, - është një fond financiar publik i cili synon punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstrukcion dhe përshtatje të vendit të punës, programe riintegrimi social, mbështetje për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara ⁶⁵.
- **Programi i punëve publike në komunitet**⁶⁶, - është një program 12 mujor, që ka për qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuarve të papunë afatgjatë (jo më pak se 12 muaj të regjistruar dhe mbi 25 vjeç), nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit (kujdesi për fëmijët, kujdes shëndetësor dhe social, rehabilitim përdoruesve të drogës, mjedisi, këshillim informim, rinore, sporti, arti, turizmi dhe kulturë).
- **Programi i nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit**⁶⁷, - është nxitja e vetëpunësimit nëpërmjet krijimit të sipërmarrjeve të reja të punëkërkuarve të papunë të interesuar Aplikuesi/ja duhet të jetë punëkërkuar i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit. Punëkërkuarët mund të përfitojë vetëm një herë nga ky program. Subvencioni është deri në masën 500 000 lekë. Afati i zbatimit të këtyre programeve është 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Efektet financiare perballohen nga buxheti i shtetit dhe fondi social i punësimit.
- **Garancia Rinore**⁶⁸, - është një angazhim nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe tashme shtrirë dhe në vendet e Ballkanit, e cila synon të garantojë që të gjithë të rinjtë dhe të rejtat nën moshën 30 vjeç të marrin një ofertë pune cilësore; edukimi i vazhdueshëm; praktika; stazhi brenda një periudhe prej katër muajsh nga ngecja e papunë ose largimi nga arsimit.
- **Programe dhe projekte zbatuar nga donatorë dhe partner në zhvillim**, - janë disa programe dhe nisma që po zbatohen nga ProSEED GIZm Ambasada Suedeze, UNDP, UNICEF. Partners Albania, Risi Albania, etj) të cilët mbështesin nisma dhe ide rinore duke synuar fuqizimin e të rinjve dhe të rejave.

⁶⁴ VKM 23.02.2018 “Fondi i Social i Punësimit”;

⁶⁵ VKM 23.02.2018 “Fondi i Social i Punësimit”, nenin 3, pika 4, shkronja “c”;

⁶⁶ VKM nr.535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”.

⁶⁷ VKM 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”.

⁶⁸ <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1161&langId=en>

